RAPORT VJETOR

PËR MONITORIMIN E

GJUHËS SË URREJTJES

NË NIVEL LOKAL NË QYTETET: TETOVË, MANASTIR DHE SHTIP

KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SHKUP, DHJETOR 2020

FOUNDATION OPEN SOCIETY MACEDONIA
ФОНДАЦИЈА ОТВОРЕНО ОПШТЕСТВО МАКЕДОНИЈА

RAPORT VJETOR PËR MONITORIMIN E GJUHËS SË URREJTJES NË NIVEL LOKAL NË QYTETET: TETOVË, MANASTIR DHE SHTIP

SHKUP, DHJETOR 2020

Botues
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut,
përfaqësuar nga Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktore
Uranija Pirovska, Drejtore ekzekutive

Autorë
Slavica Anastasovska, Oliver Mitov

Bashkëpunëtor profesional
Aleksandar Jovanoski

Lekturë
Natasha Peshevska

Tirazhi
100 kopje

Përkthimi në gjuhën shqipe
Paulin Jano

Projekti është i financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.
Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e përdoruesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

PËRMBAJTJA

Hyrje – 7

Qasja metodologjike gjatë përpunimit të raportit – 8

Qëllimi i raportit – 9

Gjendja e përgjithshme me problemin e gjuhës së urrejtjes
në nivel kombëtar për vitin 2020 – 9

Gjuha e urrejtjes në nivel lokal me referencë të veçantë në qytet: Tetovë, Manastir dhe Shtip – — — — — — — — — — – 13

Njohuri të fituara nga takimet e mbajtura me përfaqësuesit e Sektorëve të punëve të brendshme në Tetovë, Manastir dhe Shtip – — – 25

Konkluzione – — — — — — — — — — — — — – 26

Rekomandime – — — — — — — — — — — — — – 27

HYRJE

Gjuha e urrejtjes dhe komunikimi agresiv janë të pranishëm në mënyrë të vazhdueshme në media, në rrjetet sociale si edhe në komunikimin e përditshëm. Gjuha e tillë është e pranuar si një lloj "shprehjeje normale" e qëndrimeve, me të cilat njerëzit japin shqyrtim kritik ose fyejnë rreth një temë të caktuar ose shfaqje shoqërore. Mos toleranca dhe padurimi në komunikimin publik është pasojë e paragjykimeve të rrënjosura dhe stereotipave ndaj grupeve të veçanta në shoqërinë tonë. Një nga definicionet e numërta (shumta) që e përcaktojnë esencën e problemit është se gjuha e urrejtjes është formë mbresëlënëse e shprehjes, që llogaritet si fyese për cilindo grup race, religjioz ose grup kombëtar.[1]

Gjendja e tillë i sifon edhe krimet nga urrejtja[2], respektivisht padurimi i shprehur verbal shpeshherë çon drejt incidenteve të dhunshme, në të cilat viktima dhe ekzekutues janë kryesisht njerëz të rinj. Dhuna ndërmjet grupeve tifozë janë një nga format më të shpeshta dhe më të ilustruara të veprave të urrejtjes të pranishme tek ne.

Liria e shprehjes paraqet të drejtë themelore të mbrojtur me akte ligjore vendase[3] dhe akte ligjore ndërkombëtare[4], por megjithatë është vështirë e qartë që të përcaktohen kufijtë e saj. Ndonjëherë, linja është aq e hollë sa që shprehja e lirë kalon shumë lehtë në gjuhë urrejtjeje. Prej këtu, një nga sfidat themelore në këtë fushë është njohja dhe definimi i gjuhës së urrejtjes, dhe më tej edhe parandalimi dhe sanksionimi i gjuhës së tillë.

Sistemi gjyqësor, dhe para së gjithash prokuroria, ka rol kyç në këtë proces, duke e pasur obligimin për të themeluar mekanizma efikase të mbrojtjes dhe parandalimit efektiv, nëpërmjet qasjes së matur penologjike në plan të përgjithshëm dhe special. Mosndëshkimi i gjuhës së urrejtjes është i palejueshëm.

Për intensitetin e fuqishëm të gjuhës së urrejtës në kontekstin maqedonas, faktor veçanërisht i rëndësishëm është ndarja etnike, politike dhe sociale në shoqëri. Dukshmëria e kësaj dukurie është veçanërisht e shprehur në rrjetet sociale[5] që ndodh falë përdorimit të tyre gjithnjë e më masiv. Një nga karakteristikat themelore të gjuhës së urrejtës në internet është anonimiteti.[6] Përdorimi i rrjeteve sociale nuk kërkon zbulim të identitetit të vërtetë të individit. Ajo i inkurajon njerëzit që ta thonë atë që ndryshe nuk do të mund ta thoshin sy më sy.[7] Karakteristikë tjetër e njohur e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale është ekzistimi i distancës fizike ndërmjet folësit dhe publikut dhe ajo e nxit në mënyrë plotësuese individin që ta shprehë revoltën, zemërimin, padurimin e tij nëpërmjet përhapjes së urrejtjes ndaj personave të tjerë dhe ndaj grupeve të tëra të qytetarëve.

Gjatë vitit 2020 ishin shënuar një numër i konsiderueshëm i rasteve të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, në bazë të përkatësisë politike dhe ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet gjinor. Përkatësia etnike paraprin si bazë edhe në nivel kombëtar edhe në nivel lokal në mjediset e mbikëqyrura. Sipas viteve paraprake nuk ka përmirësim në lidhje me gjendjen e gjuhës së urrejtjes në vitin 2020.

[1] Samuel Walker, Hate Speech: The History of an American Controversy, Lincoln University of Nebraska, Press. 1994

[2] Si vepër e urrejtjes parashikuar shprehimisht me dispozitat e Kodit Penal, konsiderohet vepër penale kundër personit fizik ose personit juridik dhe me persona të lidhura me to ose pronë, që është kryer në tërësi ose pjesërisht për shkak të karakteristikës reale ose të supozuar (të menduar, të imagjinuar) ose lidhshmëri të personit që sillet me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, prejardhjen etnike, religjionin ose bindjen, pengesën mendore apo fizike, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjen politike

[3] Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut e garanton lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjen publike të mendimit. Garantohet liria e gjuhës, paraqitja publike, informimi publik dhe formimi i lirë i institucioneve të informimit publik.

[4] Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike: Asnjeri nuk duhet të shqetësohet për mendimin e tij dhe secili ka të drejtë për shprehje të lirë. Neni 10 i KEDNJ gjithashtu e garanton lirinë e mendimit dhe lirinë e të shprehurit.

[5] Në platformën www.govornaomrza.mk, në vitin 2020 është regjistruar numë i rritur i raportimeve për raste të gjuhës së urrejtjes për 280% në krahasim me vitin 2019.

[6] Brown, A. (2017) »What is so special about online (as compared to offline) hate speech?«, Ethnicities, 2-11

[7] ibid

QASJA METODOLOGJIKE GJATË PËRPUNIMIT TË RAPORTIT

Gjatë përpunimit të raportit, ekipi projektues përdori qasje analitike – sintetike në lidhje me mbledhjen e të dhënave, dokumentimin dhe analizimin e tyre. Procesi i mbledhjes së të dhënave, respektivisht i rasteve të shënuara të gjuhës së urrejtjes në qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip bëhej në nivel mujor.

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut për nevojat e projektit "Aksioni i përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes" angazhoi gjashtë bashkëpunëtorë të jashtëm. Nga dy bashkëpunëtorë nga Tetova, Manastiri dhe Shtip, në koordinim me ekipin e projektit, e ndiqnin gjuhën e urrejtjes në qytetet e tyre. Bashkëpunëtorët e jashtëm ishin të trajnuar që të njohin gjuhën e urrejtjes, ta përcaktojnë bazën ligjore, karakteristikën mbrojtëse dhe të bëjnë dallimin ndërmjet gjuhës së urrejtjes dhe fyerjes ose shpifjes. Rastet e gjuhës së urrejtjes ishin të raportuara nga bashkëpunëtorët e huaj dhe më pas ishin të konfirmuara dhe të verifikuara nga koordinatori i projektit. Analiza e raportimeve të miratuara të rasteve të gjuhës së urrejtjes janë burimi i përgatitjes së raportit.

Ndjekja e gjuhës së urrejtjes në nivel lokal nënkupton edhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë në terren të rasteve nëpërmjet ndjekjes së garave sportive dhe eventeve të tjera publike ku mblidhen njerëz – koncerte, ekspozita, takime politike etj. Por masat restriktive për parandalimin e Covid – 19 e pamundësuar organizimin e eventeve publike, dhe në këtë rast mungoi edhe monitorimi i tyre. Subjekti i ndjekjes ishin mediat lokale të shtypura dhe elektronike, dhe paralelisht mbikëqyrej edhe hapësira e internetit. Gjithashtu, në të tre qytetet ishin evidentuar grafitë dhe vizatime me mesazhe të gjuhës së urrejtjes, të shkruara në hapësira dhe sipërfaqe publike.

Nga aspekti metodologjik, si veglat më të përshtatshme për përgatitje të raportit janë përdorur teknikat për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet mbikëqyrjes direkte dhe shënimit. Platforma online www.govornaomraza.mk[8] është shfrytëzuar si vegël me të cilën rastet e raportuara të gjuhës së urrejtjes janë të përpunuara në mënyrë kualitative dhe kuantitative. Në këtë mënyrë, sipas të dhënave të fituara statistikore janë tërhequr përfundime për intensitetin dhe për bazat më të përfaqësuara të gjuhës së urrejtjes.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit ishin realizuar gjithsej tre takime pune me përfaqësuesit e Sektorëve të punëve të brendshme në të tre qytetet. Ekipi i projektit i analizoi njohuritë e fituara nga takimet për problemet më të cilat hasen hetuesit nga të tre qytetet. Ata janë të lidhur me mbledhjen e dëshmive, si edhe me zbulimin e autorëve dhe proçesimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes para gjykatave. Kjo qasje e bashkëpunimit direkt dhe e takimeve me përfaqësuesit e Ministrisë së punëve të brendshme paraqet vegël plotësuese për analizën e efikasitetit të mekanizmave juridike për parandalimin e gjuhës së urrejtjes.

Raporti e përfshin periudhën kohore nga data 1 janar 2020 deri më datën 30 nëntor 2020.

[8] Platformë interneti për ndjekjen e gjuhës së urrejtjes në Maqedoninë e Veriut

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti ka për qëllim që t'i prezantojë rastet e gjuhës së urrejtjes në të tre mjediset lokale gjatë vitit 2020, njëkohësisht duke i analizuar trendet aktuale të fushës.

Raporti gjithashtu është në drejtim të përmbushjes së qëllimit të përgjithshëm të projektit "Aksion i përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes", për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e tolerancës, respektin dhe barazisë, përballë pasojave të dëmshme nga urrejtja në diskursin publik.

Gjendja e përgjithshme me problemin e gjuhës së urrejtjes në nivel kombëtar për vitin 2020

Me krijimin e platformës së internetit **govornaomraza.mk** në vitin 2014, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut filloi të mbledhë të dhëna për gjendjet në këtë fushë, duke i pasur parasysh pasojat e dëmshme nga përhapja e urrejtjes për sigurinë e qytetarëve dhe për kohezionin shoqëror. Më tej, veçohet e dhëna alarmante që në periudhën nga viti 2018 – 2020 është shënuar trend i rritjes së gjuhës së urrejtjes, dhe numri i rasteve çdo vit është dyfish më i madh se viti paraprak.[9]

Në **vitin 2018** janë regjistruar 132[10] raste të gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 64 janë në bazë të përkatësisë etnike, 43 raste në bazë të përkatësisë politike, 29 raste të gjuhës së urrejtjes janë në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, dhe 16 raste janë në bazë të gjinisë. Më tej janë evidentuar raste që kanë të bëjnë me referimin e talljes së përfaqësuesve të vendeve të huaja (12 raste) dhe gjuhë urrejtjeje në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës (7 raste). Rastet e tjera janë gjuhë e urrejtjes për shkak të prejardhjes sociale, religjionit dhe besimit religjioz (fetar), si edhe gjuhë urrejtjeje ndaj përfaqësueseve të organizatave ndërkombëtare.
Deri më shumë se 1/3 e rasteve, respektivisht 34 %, janë raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, dhe me 24% pasojë rastet e gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike.

Në **vitin 2019** është shënuar rritje e rasteve të regjistruara të gjuhës së urrejtjes krahasuar me viti paraprak 2018. Në platformën govornaomraza.mk janë regjistruar 538[11] raste të gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 207 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, 206 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe në bazë të identitetit gjinor, 112 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike, 109 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të gjinisë. Në vitin 2019, gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike dhe gjuha e urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe ajo në bazë të identitetit gjinor janë më të përfaqësuarat, me nga 30% nga numri i përgjithshëm i rasteve.

[9] Burimi platforma e internetit www.govornaomraza.mk
[10] Ibid
[11] Ibid

Në vitin 2020 numri i rasteve të gjuhës së urrejtjes përsëri u rrit dhe ajo përafërsisht dy herë në krahasim me vitin e kaluar 2019. Në vitin 2020 janë regjistruar gjithsej 1119[12] raste. Përkatësia etnike edhe më tej është baza më e përfaqësuar, e njohur në 611 raste. 340 e rasteve të gjuhës së urrejtjes janë në bazë të përkatësisë politike, 273 raste në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, 64 raste janë në bazë të prejardhjes sociale dhe 59 raste të gjuhës së urrejtjes janë në bazë të gjinisë. Edhe më tej forma më e përfaqësuar, me 41% nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara, është gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, dhe me 23% përfaqësim, pason gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike. Urrejtja ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI renditet në vendin e lartë të tretë me 18 % nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara të gjuhës së urrejtjes në vitin 2020.

Edhe këto të dhëna të fundit vërtetojnë se përkatësia etnike dhe përkatësia politike, si edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë llojet më të përfaqësuara të gjuhës së urrejtjes në Maqedoninë e Veriut në kontinuitet (në mënyrë të vazhdueshme) prej disa vitesh.

Paraqitje e trendit të zmadhimit të gjuhës së urrejtjes nga nëntori i vitit 2018 deri në nëntor të vitit 2020



Duke e analizuar gjendjen e gjuhës së urrejtjes në nivel kombëtar, mund të arrihet në përfundimin se prania më e shpeshtë e gjuhës së tillë është e lidhur ngushtë me shoqërinë – me ngjarjet politike. Në vitin 2020 disa ngjarje të rëndësishme shkaktuar ortek komentesh nëpër mediat sociale. Ato ngjarje i shënuan të ashtuquajturat "kulme" në ngjarjeve të dokumentuara të gjuhës së urrejtjes në vitin 2020 në nivel kombëtar dhe lokal.

Në **janar** të vitit 2020 ishte publikuar fushata "Diskriminimi përfundon me mua"[13], e destinuar për avancimin e të drejtave të komunitetit LGBTI. Kjo fushatë ishte e kritikuar me shpërthime të mëdha të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI. Në ditën e fillimit të fushatës, 31 janar, në platformën www.govornaomraza.mk u regjistruan numri më i madh i rasteve të gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual.[14] Gjysma nga gjithsej 68 rastet e raportuara në atë muaj janë kanë ndodhur mbi atë bazë.

[12] Ibid
[13] https://theworldnews.net/mk-news/kampanja-diskriminatsijata-zavrshuva-so-mene
[14] www.govornaomraza.mk

Në **shkurt** të vitit 2020[15], shpërbërja e Parlamentit me rastin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe marrja e një pakete ligjesh, ndër të cilat dhe Ligjin për Prokurorinë publike, shkaktoi një valë të gjuhës së urrejtjes ndaj disidentëve politikë, dhe e pranishme ishte edhe gjuha e urrejtjes midis grupeve të ndryshme etnike.[16] Nga 62 rastet e raportuara, 30 themelohen mbi përkatësinë etnike, dhe 17 raste mbi përkatësinë politike.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në muajin **mars** 2020[17] për shkak të rrezikut nga përhapja e pakontrolluar e koronavirusit, ndikoi edhe mbi monitorimin e gjuhës së urrejtjes. Më saktë, fokusi nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare u transferuara në gjendjet e lidhura me gjendjen e jashtëzakonshme, dhe u krijua mundësi për mbledhjen e të dhënave për edhe një kategori mbrojtëse – gjendja shëndetësore. Nga 113 rastet e raportuara të gjuhës së urrejtjes në muajin mars, 49 raste janë gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, ndërsa 42 rase janë gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike. Në muajin mars janë regjistruar shtatë rastet e para të gjuhës së urrejtjes në bazë të gjendjes shëndetësore.

Në muajin **prill**, kriza shëndetësore dhe dimensioni ndëretnik, por edhe padurimi ndërmjet grupeve të ndryshme etnike ishte lehtësisht i dukshëm.[18] Në këtë periudhë, gjatë kohës së festave të pashkëve, filloi rendi i një sërë masave restriktive që e rritën padurimin edhe në plan etnik. Prej këtu nga 112 rastet e raportuara të gjuhës së urrejtjes, 53 raste janë në bazë të përkatësisë etnike.

Mbajtja e mbledhjes në muajin **maj**[19] me rastin e festës myslimane Ramazan Bajram[20] i ndezi pasionet dhe shkaktoi gjuhë të urrejtjes të bazuar në mënyrë etnike dhe fetare. Gjatë muajit maj, 46% e rasteve janë gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, dhe 20% e rasteve janë gjuhë e urrejtës në bazë të përkatësisë politike.

Qershori ishte shënuar vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Nga rastet e shënuara gjatë këtij muaji, 34% e kanë përkatësinë etnike si bazë, ndërsa 26% e rasteve janë në bazë të përkatësisë politike.

Muaji **korrik** e shënoi fushatën për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.[21] Mënyra në të cilën udhëhiqej kjo fushatë politike si rezultat i masave mbrojtëse ndaj COVID-19, pjesa më e madhe e mesazheve nga ana e partive politike ishin të transmetuara dhe të diskutuara në mediat sociale. Edhe pse një pjesë e madhe e fushatës udhëhiqej në mënyrë virtuale, megjithatë pasonte edhe fushatë tradicionale me mbajtjen e mitingjeve ku nuk respektoheshin deri në fund masat e mbrojtjes (veçanërisht mbajtja e maskave). Kjo kontribuoi në shkëmbimin e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale, që përveç kontekstit politik, fitoi edhe kontekst etnik.

[15] Vendim nga Kryetari i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër 09-1422/2 më datën 16.02.2020 për njoftimin e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

[16] Ibid

[17] Ibid

[18] https://www.youtube.com/watch?v=mzZaJgXtKpk&feature=emb_title.

[19] https://mhc.org.mk/media/pandemi%d1%98ata-i-izborite-gi-vzheshti%d1%98a-soczi%d1%98alnite-so-govor-na-omraza/?fbclid=IwAR3BLQYqMT00OcY3HDB7Ng_gSO4dhxibRQyBQCa0nAtqcR7Qq0dcQ1Vplms

[20] https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshta%d1%98-za-choveko-vite-prava-vo-republika-severna-makedoni%d1%98a-ma%d1%98-2020/?fbclid=IwAR1Bt7Jp3-8-CDT7HPFxMuDPqJCrd4EzuQ7MHTBueYjmRPundEaMb6LqT7o

[21] Zgjedhje Parlamentare 2020, 15 korrik, viti 2020

Në **gusht**[22] vazhdoi diskursi negativ nga periudha e pas zgjedhjeve në korrik, me retorikë jashtëzakonisht të intensifikuar dhe ofenduese. Negociatat rreth qeverisë së re prodhonin gjuhë plot me urrejtje që para së gjithash ishte e karakterit etnik në kontekst të negociatave për përbërjen e Qeverisë së re. Ishte përdorur gjuhë ofenduese drejtpërdrejt ndaj politikanëve të caktuar, duke i quajtur ata "të shitur", "tradhtarë" etj. Në muajin gusht raporti është si në vijim: 46% e rasteve të regjistruara janë gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, ndërsa 22% e rasteve janë në bazë të përkatësisë politike.[23] Gjithashtu, në periudhë më të gjatë kohore vihet re rritje e gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe në bazë të identitetit gjinor.

[22] Vendimi për zgjedhje të qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë me nr. 210/2020 e datës 30.08.2020
[23] Burimi platforma e internetit www.govornaomraza.mk

GJUHA E URREJTJES NË NIVEL LOKAL ME REFERENCË TË VEÇANTË PËR QYTETET E TETOVËS, MANASTIRIT DHE SHTIP

Megjithëse çdo qytet ka karakteristikat dhe specifikat e veta, konteksti lokal në Tetovë, Manastir dhe Shtip është i ngjashëm me kontekstin kombëtar. Identike me nivelin e të gjithë vendit dhe në këto tre qytete, bazat më të zakonshme për gjuhën e urrejtjes janë përkatësia etnike, përkatësia politike dhe gjuha e urrejtjes ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI. Në të tre qytetet, përveç komenteve të shprehura me fjalë dhe foto në rrjetet sociale, mbishkrime dhe vizatime me përmbajtje fyese u panë në hapësirat publike që shkaktojnë mostolerancë, mosrespektim dhe urrejtje midis njerëzve dhe komuniteteve. Kriza globale e shëndetit ka rezultuar në anulimin e ngjarjeve të shumta, kështu që nuk ka raportuar raste të gjuhës së urrejtjes nga ngjarjet publike në tre qytete.

Ndjekja e gjuhës së urrejtjes ishte e përshtatur me fokus të ndjekjes së stacioneve të radios dhe televizionit, si edhe në mediave sociale. Në nivel lokal ishin monitoruar postimet nga portalet lokale, televizionet, etj., profilet lokale të Twitter dhe Facebook dhe grupet që postuan përmbajtje në lidhje me kontekstin lokal.

Në Tetovë ndiqeshin – portalet e internetit: Tetovo denes, Tetovo info, Tetova sot, si edhe faqe e fan në facebook të VMRO OK Tetovo, SDSM OK Tetovo, Napred Teteks, Vojvodi, Shkendija, Ballisti etj. Nga grupet facebook ndiqej ajo me emrin – Go ljubam Tetovo.

Në Shtip ndiqeshin mediat lokale: Televizioni Star, TV Iris, Radio Kanal 77, si edhe grupet e facebook: Shtipski Aktuellnosti, San Shtipago etj.

Në Manastir ndiqej: Televizioni Tera, Portali i internetit Aplla, Bitolanews Bitola, si edhe faqet facebbok: Bitollski Problemi, Bitolla saka çist vozduh, Stari Bitollçani, Sportski natprevari etj.

TETOVË

Në Tetovë gjatë periudhës nga janari i vitit 2020 deri në nëntor të vitit 2020 ishin dokumentuar 40 raste të gjuhës së urrejtjes. 33 raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, katër raste të gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe në tre raste bëhet fjalë për gjuhë të urrejtjes në bazë të përkatësisë politike. Janë regjistruar shtatë raste të gjuhës së urrejtjes nëpërmjet vizatimeve dhe grafiteve në sipërfaqe publike në rajonin e qytetit. Gjashtë nga këto janë vizatime dhe grafite në objekte sipas bazës së përkatësisë etnike, ndërsa një vizatim përmban një mesazh urrejtjeje ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI. 33 rastet e mbetura janë të regjistruara në mediat sociale dhe përfaqësojnë publikime dhe komente nga konteksti lokal.

Në një mjedis lokal multietnik si Tetova, mbizotëron gjuha e urrejtjes e bazuar në përkatësinë etnike / kombëtare, e drejtuar nga maqedonasit te shqiptarët dhe anasjelltas. Mostoleranca, mospranimi dhe urrejtja midis dy komuniteteve më të mëdha etnike janë gjithashtu të pranishme në komunikimin në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter. Gjithashtu, në vetë qendrën të Tetovës në ndërtesa, mure dhe hapësira të tjera publike janë shkruar përmbajtje që janë fyese dhe poshtëruese për maqedonasit ose shqiptarët. Grafitet me tekste të papërshtatshme në thelb janë një thirrje për dhunë dhe është një nxitje serioze për të kryer vepra penale nga urrejtja ndërmjet banorëve të Tetovës.

Paragjykimet kundër komunitetit LGBTI janë në përputhje me trendin kombëtar të gjuhës së urrejtjes. Urrejtja për shkak të orientimit seksual dhe mospranimit të diversitetit është e dyta më e përfaqësuar në Tetovë. Ky lloj i gjuhës së urrejtjes është i pranishëm pavarësisht nga konteksti etnik.

Baza e tretë më e përfaqësuar në Tetovë është urrejtja e bazuar në përkatësinë politike. Është shënuar retorika në drejtim të nxjerrjes në pah të tradhtarëve dhe patriotëve, duke iu referuar ndarjes politike të banorëve të Tetovës.

Në vijim janë dhënë disa fotografi si shembuj të formave më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes në qytetin e Tetovës.

foto 1

Në një tunel midis dy ndërtesave në rrugën "Marshall Tito", është vënë re grafit me mbishkrim: "Vdekje për kaurët". Mbishkrimi përmban gjuhë urrejtjeje që shkakton mostolerancë dhe padurim ndaj popullit maqedonas.



foto 2

Në qendrën e Tetovës në një billboard ku bëhet thirrje për të drejta të barabarta të komunitetit LGBTI është shkruar një mbishkrim me gjuhën e urrejtjes: "Vdekje për pederastët"

komentet

"Bëjnë skrining të situatës dhe afeksionit."

"Kjo urgjent duhet të hiqet ose do të duhet rrahje."

"Do të nevojitet aksion."

foto 3

Në afërsi të Shkollës së Mesme Profesionale ekonomike "8 Shtatori" – Tetovë, është vënë re grafit me përmbajtje: "Piçka kauri". Ky grafit me përmbajtje vulgare përmban gjuhë tipike urrejtjeje në bazë të përkatësisë etnike.



foto 4

Aktivist partiak i VMRO – DPMNE nga Tetova, i kritikon në mënyrë të ashpër aktivitetet e LSDM-së në kuadër të fushatës parazgjedhore, duke publikuar përmbajtje ofenduese në profilin e tij – facebook me fjalët: alooooo mutra të prapambetur komunistësh paskeni bërë reklamë me atë qen kasapi të Syrizës si nuk keni turp". Ky publikim është shprehje e mostolerancës politike dhe padurimit të fuqishëm politik që përmban gjuhë urrejtjeje në bazë të përkatësisë politike.

foto 5

Grafit në qendër të Tetovës me përmbajtje:, "Tetova është Shqipëri".

MANASTIR

Në Manastir janë shënuar gjithsej 55 raste të gjuhës së urrejtjes. 49 raste janë shënuar në rrjetet sociale Facebook, Twitter dhe Tik Tok, ndërsa gjashtë të tjerat janë grafitë dhe vizatime në hapësirat publike në qytet. Dy nga grafitet janë me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, ndërsa ketër të tjerat kanë mesazh të urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike. Gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike është e shënuar në 36 raste[24], urrejtja ndaj komunitetit LGBTI është e shënuar në tetë raste. Pesë raste janë gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike, pesë raste janë gjuhë e urrejtjes në bazë të gjendjes shëndetësore, dhe është shënuar edhe një rast i gjuhës së urrejtjes në bazë të prejardhjes sociale.

Si anëtarë të një nga grupeve më të margjinalizuara të qytetarëve në Maqedoninë e Veriut, Romët, veçanërisht në Manastir, e durojnë gjuhën e urrejtjes më intensive[25] në komunikimin e përditshëm të rrjeteve sociale. Nga gjithsej 36 rastet e dokumentuara të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, 23[26] janë gjuhë e urrejtjes që janë në mënyrë direkte dhe eksplicite të drejtuara ndaj Romëve. Romët[27] janë të paraqitur si fajtorë për çdo problem shoqëror ose përsëri të fajësuar për shumë shfaqje sociale – patologjike, që vërtetohet në raportet mujore nga monitorimi i kryer në Manastir. Gjatë muajit shtator[28] shumë persona Romë ishin rrahur në mënyrë të mizore nga ana e policisë, dhe rasti ishte zbuluar në publik vetëm disa ditë më vonë. Kjo ngjarje shkaktoi valë të fuqishme komentesh nga qytetarë të manastirit nëpër rrjetet sociale, që i gjykonin Romët si të dëmshëm për shoqërinë.[29]

Gjuha e urrejtjes në bazë të gjendjes shëndetësore u bë më e shpeshtë veçanërisht në Manastir si pasojë e pandemisë nga koronavirusi. Por, edhe në atë kontekst, urrejtja ishte drejtuar ndaj Romëve.[30] Nga 5 rastet e regjistruara të gjuhës së urrejtjes në bazë të gjendjes shëndetësore dy kanë të bëjnë me Romët e akomoduar në karantinë shtetërore.

Si rezultat i ndarjes gjithnjë e më të madhe të shoqërisë, padurimi politik dhe mostoleranca, e shprehur nëpërmjet shpërthimeve të urrejtjes ndaj disidentëve politikë, është e pranishme edhe në Manastir. Mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe menaxhimi me krizën shëndetësore, shkaktoi gjuhë të urrejtjes në rrjetet sociale në bazë të përkatësisë politike. 10% e numrit të përgjithshëm të rasteve në Manastir janë mbi këtë bazë.

Gjuha e urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI nuk e le pas as Manastirin. Mospranimi, mostoleranca dhe diskriminimi ndaj komunitetit LGBTI është i pranishëm me intensitet të barabartë si në nivel kombëtar. Me gjithsej tetë raste të regjistruara në Manastir, nga të cilat dy janë grafitë që përmbajnë gjuhën e urrejtës ndaj komunitetit LGBTI, orientimi seksual, si bazë, është në vend të dytë sipas pranisë me 14.5% nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara në këtë qytet.

Specifike për Manastirin është fenomeni i ekzistimit të grupeve neonaziste të lidhura me sub-kulturën Skinhead.[31] Në disa lokacione nëpër qytet janë vënë re grafitë antisemitike dhe mbishkrime që janë gjuhë tipike e urrejtjes.

[24] 65% e numrit të përgjithshëm të rasteve
[25] Burimi: platforma e internetit www.govornaomraza.mk
[26] 41% e rasteve të përgjithshme të regjistruara në Manastir janë gjuhë e urrejtjes drejtuar ndaj Romëve
[27] https://mhc.org.mk/media/helsinshki-i-ava%d1%98a-reagiraat-na-nov-slucha%d1%98-na-policziska-brutalnost-kon-romi-vo-bitola/?fbclid=IwAR1hiAkmqjEcMfMEblpKjKi9oE9MJI27nlCEelr_ybkJTPZcyojeRLEXS4A
[28] https://www.slobodenpecat.mk/pretepanite-romi-od-bitolskata-policzija-svedochea-vo-zhivo-ne-maltretiraa-kako-stoka-ne-tepaa-i-drzhea-vo-stanicza-do-5-sabajle-video/
[29] Burimi platforma e internetit www.govornaomraza.mk (Një nga komentet e shumta: "Dhe evgjitët në Manastir janë plagë kanceri në qytet. E qelbën të gjithë qytetin, vjedhin, bëjnë prostitucion dhe e pështirosën të gjithë qytetin")
[30] Burimi platforma e internetit www.govornaomraza.mk (Rasti me Romët e Manastirit të drejtuar në karantinë shtetërore në kazermat "Krivollak")
[31] Skinehead(s) dhe, Skinsi (angl. skinheads, "kokë rrojturit") i përkasin një nën-kulture që ka prejardhjen nga përkatësit e rinj të klasës punëtore në Mbretërinë e Bashkuar në vitetgjashtëdhjetë (1968-1969).

Në vijim janë dhënë disa fotografi si shembuj të formave më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes në qytetin e Manastirit.

foto 1

Në rr. "Jane Sananski" në katin e parë të objektit të njohur me emrin "Sheherezad" është shkruar mbishkrimi „shiptar" dhe gjithashtu janë vizatuar edhe më shumë kryqe të thyer.

Në Facebook nëpërmjet opsionit „story" nga profil privat ishte shpërndarë fotografi që nxit dhe përhap urrejtje ndaj komunitetit LGBTI.

foto 2

foto 3

Në hapjen e përvjetorit të 15-të të festivalit AKTO për art modern në fasadën e kinemasë "Partizan" në Manastir ishte mbishkruar mesazh "Të zinj, të bardhë, ezmerë, të verdhë, harrojini grindjet e vjetra. Sapo të filloni të bisedoni me njerëzit së bashku, së shpejti të gjithë do të jemi në një mendje"," pjesë nga "Kënga për solidaritetin" e Bertold Brech. Për jo plot 24 orë, gjatë natës, me ngjyrë të zezë ishte shkruar mesazhi "Vdekje për Serbët!! + Vdekje për Shiptarët!!!"

Në faqen – facebook të grupit "Bitollski problemi" ishte publikuar lajm në lidhje me renovimin e vendpushimit të fëmijëve në Parkun kombëtar Pelister. Në vijim të publikimit nga përdorues të rrjetit social janë shkruar komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes ndaj përkatësve të partisë politike.

komentet

"Për ju vetëm Hitleri dhe secili sipas meritës, por mendoj më mirë (t'ju bëjnë) sapun dhe DERRAT t'i lajmë me të".

"Mengele duhet një spot i ri."



foto 4

foto 5

Në kuadër të grupit - facebook "Bitollski problemi" ishte vendosur publikim nga ana e anëtarit të grupit me fotografi dhe me tekstin Do na vdesin evgjitët për votat e shkreta".



foto 6

komentet

"Ore një muaj t'ju mbajnë atje, dhe e di që në shtëpi nuk jemi më mirë se në Krivollak."

"Ajde vëlla, unë do të çoj tek të gjithë Romët të shikosh se si jetojnë, dhe ti çfarë personi je, i keq dhe ke diçka kundër Romëve, që nuk është OK në shekullin e 21. Asnjë gjë të keqe nuk ju kemi bërë dhe mos komentoni mutra, të lexojnë të gjithë. Shiko në Demir Hisar se si jetoni."

"Abe, nga Manastiri jam edhe unë."

Grupi i Romëve të akomduar në karantinë në kazermën në Krivollak njoftojnë për kushtet e tmerrshme në të cilat janë akomoduar, duke publikuar video për gjendjen atje: https://www.youtube.com/watch?v=mzZaJgXtKpk&feature=emb_title. Qytetarët Romë thonë se të gjithë të tjerët ishin lëshuar në izolim shtëpiak respektivisht në karantinë dhe se vetëm ata janë mbajtur atje. Ky lajm është i publikuar nga ana e televizionit lokal Tera, në vijim e publikimit pasojnë kritika të ashpra dhe urrejtje ndaj këtyre njerëzve sepse nuk paskan mundur që t'i durojnë dot kushtet.

SHTIP

Në Shtip, gjendja me gjuhën e urrejtjes sipas shpeshtësisë dhe intensitet është përafërsisht me dy qytetet e tjera. Padurimi dhe mospranimi i dallimeve vijnë në dukje nëpërmjet gjuhën së dukshme diskriminuese në rrjetet sociale. Identike me kontekstin kombëtar, gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike është më e përfaqësuar edhe në këtë qytet. E njëjta sillet edhe me urrejtjen për shkak të përkatësisë politike.

Sulmet verbale ndaj komunitetit LGBTI janë gjithashtu një nga llojet e përfaqësuara më të shpeshta të urrejtjes në komunikimin e përditshëm të rrjeteve sociale, dhe i pranishëm edhe në formë të grafike në hapësirat publike nëpër qytet. Në Shtip është shënuar gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë fetare, respektivisht përkatësisë religjioze, veçanërisht gjatë festave fetare.

Në Shtip janë shënuar gjithsej 36 raste të gjuhës së urrejtjes. Gjuha e urrejtjes na bazë të përkatësisë etnike është më e përfaqësuar me gjithsej 23 raste. Gjashtë nga rastet janë gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike, dhe gjashtë raste janë në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Është shënuar një rast i gjuhës së urrejtjes në bazë të religjionit dhe përkatësisë religjioze (fetare). Tre raste të gjuhës së urrejtjes janë të evidentuara në vizatime dhe grafitë në objekte dhe në hapësirat publike të qytetit. Një rast është i themeluar mbi përkatësinë politike, një është gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike dhe një mbishkrim me përmbajtje të drejtuar kundër komunitetit LGBT. 33 rastet e tjera janë të regjistruara në rrjetet sociale dhe paraqesin publikime ose komente për ndodhitë në qytetin Shtip.

Në vijim janë dhënë disa fotografi si shembuj të formave më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes në qytetin Shtip.



foto 1

Grafite që përmbajnë gjuhën e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, por edhe gjuhë të fshehur të urrejtjes ndaj desidentëve politikë.



foto 2

Në faqen - facebook "Nalet da se storite" është publikuar fotografi nga një mbledhje e besimtarëve. Teksti i publikimit nxit dhe ndez padurim dhe mostolerancë, dhe përmban gjuhë të urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike dhe fetare.

komentet

"Kafshët satanike severxhane filluan me sharjen ndaj besimtarëve dhe kishës. Nëse vini re diçka të ngjashme na shkruani".

komentet

"Fushata, Vdis si shqiptar filloi... Crpko do të shkojë tani në 5 korrik në zgjedhje... Budallai u çmend..."

Në profilin - twitter "Thunder Strake" ishte publikuar fotografi me logo të modifikuar të partisë politike LSDM ku në yllin e logos është vendosur emblema e UÇK-së. Fotografia e tillë përhap dhe nxit gjuhën e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike.

foto 3

Në Shtip, në muret e stadiumit të qytetit është vizatuar instalim artistik – mural me ngjyrat e ylberit si simbol i komunitetit LGBTI. Lajmi është shpërndarë në faqen - facebook Makedonski.press dhe në vijim të publikimit pasojnë komente me gjuhën e urrejtjes, padurim-it dhe mostolerancës ndaj komunitetit LGBTI. Të njëjtën natë pas vizatimit të muralit nga ana e një grupi të panjohur autorësh mbi mural është shkruar grafit me përmbajtjen "Pederastë vdisni nga sida".

komentet

Makedonski press – "Sot stadiumi i qytetit të Shtipit duket kështu... Mundemi më shumë, mundemi më mirë!!"

"Vëllaçko, që sot në darkë muri do të zbardhet. Ne nuk duam të shikojmë psikopatë, dhe pastaj nëse shfaqeni në vend tjetër të ngjyrosni simbole pederastësh nëpër qytet do t'ju demonstroj ortopedi."

"Më jepni adresën dhe t'i dërgojmë 'artistët'."

"Ok është shok. E thatë."

"Ka ligj atje, se çfarë duhet vizatuar shok, dhe ato simbolet tuaja të pederastëve t'i vizatoni me partnerin në shtëpi dhe jo atje ku nuk e keni vendin."



foto 4.1

komentet

"Kjo është me siguri pjesë e tribunës së re që është ndërtuar."

"Nuk ka mundësi"

"Gjakun pederast."

foto 4.2

komentet

"Përfshihu lirisht, unë do t'ju përjashtoj. Do të zbardhet muri. Shtip nuk është qytet pederastësh. Atë demonstrim në vend tjetër. Kushdo që do të shfaqet duke vizatuar, do ta gjejë e keqja".

"Asnjë gjë nuk është e përjetshme, po ashtu edhe murali. Më vjen keq që as nuk e keni parë se çfarë do të vizatohet, dhe mendoni kështu. Të fala."

"Riste është OK."

"Vëllaçko, që sot në darkë muri do të zbardhet. Ne nuk duam të shikojmë psikopatë, dhe pastaj nëse shfaqeni në vend tjetër të ngjyrosni simbole pederastësh nëpër qytet..."

NJOHURI TË FITUARA NGA TAKIMET E MBAJTURA ME PËRFAQËSUESIT E SEKTORËVE TË PUNËVE TË BRENDSHME NË TETOVË, MANASTIR DHE SHTIP

Në kuadër të aktiviteteve të projektit ishin mbajtur takime me përfaqësuesit e Sektorëve të punëve të brendshme në Tetovë, Manastir dhe Shtip. Takimet ishin të mbajtura mbi të gjitha me qëllimin që të themelohet bashkëpunim por edhe të ndahen informacionet dhe përvoja për rastet e raportuara të gjuhës së urrejtjes në nivel lokal.

Konkluzioni nga të gjitha takimet është se në të gjitha mjediset inspektorët hasen me të njëjtat sfida në lidhje me problemin e gjuhës së urrejtjes. Në të tre qytetet ekzistojnë grupe tifozësh sportivë, që jo rrallë herë shkaktojnë incidente dhe gjithmonë drejtojnë mesazhe me urrejtje. Numër shumë i vogël rastesh kanë vendim përfundimtar gjyqësor.

Përveç ekzistimit të "Procedurave standarde operative" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mungojnë rregulla të qarta precize për veprimin në rastet kur ekziston gjuha e urrejtjes. Vepra të caktuara penale[32] janë shumë vëllimore që në vetvete t'i përfshijnë të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes.

Nga ana e inspektorëve ishte theksuar për nevojën për trajnime të zyrtarëve policorë he përgatitjen e Manualëve – udhëzueseve për njohjen e veprave penale, që e kanë gjuhën e urrejtjes si inkriminim. Ishin theksuar edhe vështirësi gjatë mbledhjes së dëshmive, dëshmimin e veprave penale dhe gjetjen e autorëve, dhe veçanërisht të atyre veprave të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik. Nga ana e inspektorëve ishe kërkuar që në të ardhmen trajnimet e organizuara të jenë të dizajnuara në drejtim të përpunimit të rasteve konkrete dhe shkëmbimin e praktikave më të mira evropiane.

[32] Neni 319 nga Kodi Penal – Nxitja e urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, përçarjes dhe padurimi

KONKLUZIONE

1. Gjuha e urrejtjes më e përfaqësuar në nivel kombëtar si edhe në nivel lokal është gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike.

2. Ndarja politike e qytetarëve në të tre qytetet Manastir, Shtip dhe Tetovë rezulton me gjuhë të urrejtjes ndaj desidentëve politikë.

3. Paragjykimet dhe stereotipat ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI janë të dukshme në të tre qytetet, që tregohet edhe me statistikën e gjuhës së urrejtjes ndaj këtij grupi.

4. Zhvillimi i teknologjisë çoi në zhvillim të shpejtë të mediave sociale[33] që u bënë hapësira kryesore për shkëmbimin e informacioneve dhe mesazheve me shpejtësi të madhe, dhe me atë mundësuan edhe përhapjen e shpejtë edhe të gjuhës së urrejtjes.

5. Në mungesë të kornizës së qartë ligjore dhe të trajnimeve për njohjen e gjuhës së urrejtjes, Sektorët e punëve të brendshme në të tre qytetet kanë vështirësi në shënimin, regjistrimin dhe raportimin e veprave të tilla, në mbledhjen e dëshmive dhe në procesimin e tyre tek prokuroritë publike përkatëse.

6. Është i nevojshëm ndryshim në legjislacionin në mënyrë të tillë që forma të caktuara më të lehta të gjuhës së urrejtjes do të mund të ishin të trajtuara si kundërvajtje, si edhe distinktim i qartë dhe kualifikim ligjor për të gjitha format e gjuhës së urrejtjes.

[33] Facebook, Twitter, Instagram

REKOMANDIME

Në pajtueshmëri me gjetjet dhe konkluzionet që dalin në raport, dhe me qëllim që të detektohet dhe të parandalohet intensiteti i fuqizuar i gjuhës së urrejtjes dhe ku të promovohet parimi i tolerancës dhe mos diskriminimit, propozohen këto rekomandime:

1. Themelimi i mekanizmit parandalues gjithëpërfshirës edukativ në arsimin fillor dhe të mesëm në kuadër të lëndës Edukatë Shoqërore, me qëllim pranimin e diversiteteve dhe tejkalimin e hershëm të paragjykimeve.

2. Mbështetje dhe zbatimin e fushatave publike nga ana e qeverisë ekzekutive dhe qeverisë lokale me qëllim sensibilizimin e publikut për pranimin e diversiteteve, të bazuara mbi tolerancën dhe respektin.

3. Duke pasur parasysh faktin se gjuha e urrejtjes ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual është e treta sipas përfaqësimit, rekomandojmë ndryshim të Kodit penal dhe shtimin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si një nga bazat (themelet) për ndjekje të autorëve.

4. Rol proaktiv të Ministrisë së punëve të brendshme në pjesën e ndjekjes së gjuhës së urrejtjes në mediat sociale, si edhe reagim në kohë dhe raportim të veprave të tilla.

5 Trajnime sistematike për të punësuarit në Ministrinë e punëve të brendshme në fushën e gjuhës së urrejtjes dhe kriminalitet nga urrejtja.

6 Veprim në kohë dhe efikas i Prokurorisë publike në rastet e lidhura me gjuhën e urrejtjes.

7 Themelim të kornizës së qartë ligjore me qëllim sanksionimin efektiv të gjuhës së urrejtjes.

RAPORT VJETOR PËR MONITORIMIN E GJUHËS SË URREJTJES NË NIVEL LOKAL NË QYTETET: TETOVË, MANASTIR DHE SHTIP

2020

@#%!

@#%!